

Të dashur prindër

Duke filluar nga klasa e dytë, fëmijët tuaj duhet ta shfrytëzojnë mundësinë e vijimit të mësimin plotësues në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK: Heimatlicher Sprache und Kultur – gjuha dhe kultura amtare). Me ndihmën e mësimin plotësues do të aftësohen fëmijët tuaj më shumë në gjuhën amtare. Ata do të fitojnë njohuri të gjera si p.sh në histori, gjeografi, muzikë ose për sa u përket traditave të vendit të tyre të prejardhjes. Këto njohuri të thelluara në gjuhën amtare do të ndikojnë gjithsesi edhe në mësimin dhe përvetësimin e gjuhës gjermane, në krijimin e identitetit personal dhe do t'u ndihmojnë atyre për të komunikuar me të afërmit e tyre. Këto që i përmendëm më lartë, në veçanti komunikimi me të afërmit e fëmijëve, janë shumë me rëndësi, prandaj ju udhëzojmë që fëmijën tuaj ta regjistroni në klasat e mësimin plotësues në gjuhën amtare.

Departamenti për Edukim i Kantonit të Schaffhausenit

Organizimi i mësimin plotësues në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK: Heimatlicher Sprache und Kultur – gjuha dhe kultura amtare) – Informata për prindërit

Kush

Mësimi plotësues në gjuhën amtare/Kurset HSK (gjuha dhe kultura amtare) organizohen dhe financohen prej konsullatave e ambasadave të vendit/shtetit të prejardhjes ose nga vetë prindërit.

Regjistrimi

Regjistrimi bëhet nga mësuesi/mësuesja që nga klasa e parë e shkollës fillore.

Mësimi fillon të ndiqet nga klasa e dytë. Regjistrimi mund të bëhet edhe më vonë. Prindërit mund të marrin kontakt drejtpërdrejt me udhëheqësin/udhëheqësen (mësuesin/mësuesen); Lista e personave kontaktues gjendet në Departamentin për Edukim.

Kur

Mësimi plotësues në gjuhën amtare fillon në të njëjtën kohë si viti i rregullt shkollor. Nxënëset dhe nxënësit e vijnë atë 2-4 orë në javë. Mësimi mbahen pas mbarimit të orarit të mësimin të rregullt.

Ku

Mësimi në gjuhën amtare zhvillohet në mësojtoret/klasat e godinave shkollore zvicerane.

Organizatorët e mësimin plotësues në gjuhën amtare i informojnë prindërit për vendin dhe kohën mbajtjes së mësimin.

Vlerësimi me nota në HSK (gjuha dhe kultura amtare)

Vlerësimi me nota i fëmijëve dhe të rinjve në cilëndo gjuhë, do të shënohet edhe në dëftesat e rregullta të shkollës zvicerane. Notat barten në dëftesat e rregullta nga mësimdhënësit zviceran.

Disa udhëzime të përgjithshme për prindërit për edukimin në dy ose më shumë gjuhë:

- Përdoreni në shtëpi gjuhën tuaj amtare/gjuhën e nënës.
- Evitoni përzierjen e dy gjuhëve, gjuhës amtare dhe gjermane.
- Tregojuni fëmijëve tuaj tregime në gjuhën tuaj, ose këndoni bashkë me ta këngë në gjuhën tuaj amtare.
- Lejoni fëmijët që të lexojnë libra në gjuhën amtare, por edhe në atë gjermane.
- Shikoni mësimet (detyrat) e fëmijës tuaj rregullisht. Më këtë ju shprehni interesim për fëmijën..

Adresa kontaktuese:

Organizatori i mësimin plotësues në gjuhën dhe kulturën amtare: Lidhja e prindërve dhe Mësimdhënësve Shqiptarë "Naim Frashëri"

Adresa e personit kontaktues/koordinatores për Kt. SH
Sadije Nuhiu, Engestrasse 25, 8212 Neuhausen,
Tel.052 670 19 36 / 078 751 62 54

Giovanna Maggi,
Verantwortung Administration HSK
Erziehungsdepartement
Herrenacker 3
8200 Schaffhausen

Tel.: 052 632 71 62

Email: giovanna.maggi@ktsh.ch